REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 163/17
Data/Datum. 01.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

ANKESË

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për:Kuvendi i Republikës se Kosovës, adresa Sheshi "Nena Terezë", Prishtinë

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KU101-16-063-211**

Sa i përket tenderit për: SHËRBIME HOTELIERE NË KUVENDIN EE REPUBLIKES SE KOSOVES

1. **Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK**

NTH" Shqiponja" Rr. Xheva dhe Fehmi Lladrovci, Drenas.
(Emri i OE)
Rr. Xheva dhe Fehmi Lladrovci, Drenas
(Adresa e OE)
Drenas
(Selia)
s[redacted]mail.com
(Adresa elektronike)
Fehmi Nika
(Drejtor)

(Nënshkrim) 01.06.2017 **(Data)**

NDERMARRJA TREGTARE HOTELIERE SHQIPONJA GJILOGOC

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me date 18 maj 2017 kemi pranuar nga Drejtoria e Prokurimit te Kuvendit te Kosoves ,pas procedures se rivlersimit kemi pranuar Njoftimin për eliminimin nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe njoftimin per anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit se bashku me Njoftimin per Komisionin Rregullativ te Prokurimit Publik-Njoftimi per refuzimin e tenderit jo normalisht te ulte.

Te paknaqur me Vendimin per eliminim te aktivitetit te prokurimit si dhe Njoftimin per anulim te ketij aktiviteti te prokurimit kemi ushtruar Kerkese per rishikim.

Me date 22 maj 2017 kemi ushtruar te AK, Kerkese per rishqyrtim .

Me date 24 maj kemi pranuar Vendimin mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim te Vendimit per eliminim nga aktiviteti i metejme i prokurimit dhe Njoftimin per anulim te ketij Aktiviteti te prokurimit me arsyetimin se :

Komisioni i ri-vlerësimit, pas ekzaminimit të ofertave për lëndën Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me numër të prokurimit KU101 16 063 211 (101-16-201-2-1-1) dhe pas krahasimit të artikujve në listën e KRPP-së dhe artikujve me çmimeve jo-normalisht të ulët të ofruara nga operatorët ekonomikë, konstatoi se nuk ka bazë për të krahasuar këto çmime të KRPP-së me çmimet abnormalisht të ulta të ofruara nga operatorët ekonomikë, sepse dallojnë përshkrimet e artikujve. Poashtu çmimet e publikuara në KRPP anë çmime të furnizimit, ndërsa kontrata e Kuvendit është kontratë për shërbime.

Autoriteti Kontraktues, Kuvendi i Republikës së Kosovës, konstaton se refuzimi i ofertës së operatorit ekonomik Shqiponja, për lëndën Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me numër të prokurimit KU101 16 063 211 (101-16-201-2-1-1), është bërë në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në pajtim me Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Prandaj, duke marrë parasysh arsyet e mësipërme, kërkesën për rishqyrtim e vlerëson si të pabazë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me datë 18.05 . 2017 kemi pranuar Njoftimin për eliminimin nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe njoftimin per anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit se bashku me Njoftimin per Komisionin Rregullativ te Prokurimit Publik-Njoftimi per refuzimin e tenderit jo normalisht te ulte.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK; Kuvendit të Republikës së Kosovës ne pajtim me nenin 108A të LPP-se parashtroj ankese kunder:

1. Vendimit per refuzimin e Kerekses per rishqyrtim , vendimi nr.167/17 i dates 24.05.2017,

2. Njoftimit per eliminimin nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit te datës 17.05.2017, dhe

3. Njoftimit per anulimin e aktivitetit te prokurimit : SHËRBIME HOTELIERE NË KUVENDIN EE REPUBLIKES SE KOSOVES

Pretendojmë e se AK-Kuvendi i Kosovës përmes Komisionit per rivlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, *(në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë) konkretisht:.*

- *Neni 1 , Qëllimi,*
- *Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*
- *Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave*
- *Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,*
- *Neni 61 , Tenderët Jo-Normalisht te ultë*
- *Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit te prokurimit,*
- *Nenit 105, Kompetencat e OSHP-se,*

II/ Udhëzuesit operativ të prokurimit publik

- **Neni 42** , *Tenderët Jo-normalisht të Ulët,të*
- *Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet